

# Buxheti 2018 dhe Rekomandimet e Komisionit Evropian

Tetor 2018





# Përmbajtja

<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>Administrata Publike</b>	<b>6</b>
<b>Zhvillimi i tregut</b>	<b>8</b>
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)	9
Agjencia Kosovare për Standardizim	9
Drejtoria e Akreditimit të Kosovës	9
Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit	9
Inspektorati i Tregut	9
Agjencioni i Metrologjisë së Kosovës	10
Agjencia e Pronës Industriale	10
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	11
<b>Energjia</b>	<b>12</b>
Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)	13
Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE)	13
<b>Bujqësia dhe transporti</b>	<b>14</b>
Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë	15
Transporti	15
<b>Shëndetësia dhe mjedisi</b>	<b>16</b>
Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit	17
<b>Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore</b>	<b>18</b>
Prokuroria dhe gjyqësori	19
Lufta kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit	20
Migracioni dhe azili	21
<b>Arsimi</b>	<b>22</b>
<b>Media dhe statistikat</b>	<b>24</b>
<b>Buxhetet komunale</b>	<b>26</b>
<b>Përfundime dhe rekomandime</b>	<b>27</b>
<b>Anekset</b>	<b>28</b>
Aneks 1	28



# Hyrje

Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, ishte dorëzuar në Kuvendin e Kosovës me 31 tetor 2017.<sup>1</sup> Në prezantimin e Ministrit të Financave para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, askund nuk ishte përmendur nëse Qeveria e Kosovës ka pasur ndonjë prioritet sa i përket rekomandimeve që dalin nga Raporti i Komisionit Evropian (KE) për Kosovën për vitin 2017.<sup>2</sup> Përderisa integrimi në Bashkimin Evropian është njëra ndër prioritet kryesorë të shtetit të Kosovës, buxheti ishte miratuar nga deputetët e Republikës së Kosovës më datë 22 dhjetor 2017 në një seancë të jashtëzakonshme dhe pa ndonjë diskutim thelbësor për rekomandimet e këtij Raportit të KE-së. Qëllimi i kësaj analize është të shohim se sa i ka plotësuar buxheti i Republikës së Kosovës rekomandimet e raportit të KE-së nga viti paraprak dhe cilat janë prioritetet që Kuvendi i Kosovës duhet t'i ketë parasysh gjatë shqyrtimit të buxhetit për vitin 2019 duke u bazuar në rekomandimet e raportit të KE-së të këtij viti.

Për dallim nga vitet tjera kur Raporti i KE-së publikohej në muajin nëntor dhe përfshinte zhvillimet deri në fund të shtatorit të atij viti,<sup>3</sup> sivjet ky raport u publikua në muajin mars dhe përfshinte periudhën deri në fund të muajit shkurt të këtij viti.<sup>4</sup> Megjithëse në këtë analizë kemi gjetur se shumë nga rekomandimet e KE-së nuk janë marrë parasysh në buxhetin e vitit 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e ka rishikuar buxhetin e këtij viti me arsyetimin se ka pasur planifikim shumë të mirë të buxhetit.

Të gjeturat tona tregojnë se megjithëse ka rritje të buxhetit për disa institucione që ka rekomanduar KE, kjo rritje mbetet e pamjaftueshme. Në fushën e administratës publike, problematike mbetet fragmentimi dhe mungesa e buxhetit adekuat për zbatimin e strategjive në këtë sektor. Gjithashtu, me gjithë rritjen e buxhetit për sundimin e ligjit, buxheti i ndarë për zbatimin e strategjisë kundër korrupsion është i pamjaftueshëm. Në anën tjetër, institucionet kyçe të cilat sigurojnë zhvillimin e tregut në kuadër të MTI-së mbeten me kapacitete të kufizuara njerëzore dhe financiare. Edhe shpenzimet në arsim dhe shëndetësi mbesin të pamjaftueshme dhe ndër më të ulëtat në rajon. Kosova shpenzon më së paku në rajon për hulumtime shkencore, ndërsa rreth 40% e shpenzimeve në shëndetësi paguhen nga xhepat e qytetarëve dhe kjo është rreth dyfishi i përqindjes së shpenzimeve të qytetarëve në BE. Së fundmi, me gjithë rekomandimin për një gjetje të qëndrueshme të financimit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) kjo çështje nuk është zgjidhur për vite me radhë.

---

Shkrimi i këtij raporti ka përfunduar në gusht 2018

1 Kuvendi i Kosovës, Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>

2 Kuvendi i Kosovës, Procesverbal i mbledhjes së Komisionit për buxhet dhe financa, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>


3 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxwg>

4 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViiP>, faqe 3



Njëra ndër problemet e ngritura nga Raporti i Komisionit Evropian këtë vit është edhe çështja e madhësisë së Qeverisë së Kosovës. Sipas një studimi të Institutit GAP, në mënyrë që Qeveria e Kosovës të funksionojë në mënyrë optimale dhe të shmang problemin e shpërndarjes së kompetencave nëpër ministri të ndryshme, do të duhej ta ulte numrin e ministrive nga 21 në 13.<sup>5</sup> Sipas kalkulimit tonë, nga kjo ulje e numrit të ministrive, vetëm nga shpenzimet e pagave, telefonisë mobile dhe drekave, buxhetit të Kosovës do t'i kurseheshin rreth 3.2 milionë euro në vit apo 12.9 milionë euro për një mandat qeverisës prej katër vitësh. Kjo për shkak të uljes së numrit të ministrave, zëvendës ministrave, këshilltarëve dhe stafit tjetër politik.<sup>6</sup>

**FIGURA 1: ULJA E DISA SHPENZIMEVE NGA ZVOGËLIMI I MINISTRIVE NGA 21 NË 13**



**Burimi:** Kalkulim i Institutit GAP

Problem tjetër që ndikon në fragmentimin e administratës publike mbetet edhe numri i madh i agjencive (gjysmë) të pavarura. Sipas raportit, fragmentimi i këtyre agjencive dëmton llogaridhënien dhe efciencën, prandaj këto agjenci duhet të kalojnë nga Kuvendi në Qeverinë e Kosovës.<sup>7</sup> Ministria e Administratës Publike (MAP) ka hapur procesin e konsultimeve publike për koncept dokumentin i cili synon kalimin e shtatë agjencive nën menaxhimin e qeverisë brenda vitit 2018. Ky dokument nuk paraqet një shifër të saktë të kursimeve buxhetore, mirëpo për shkak të uljes së numrit të anëtarëve të bordeve, drejtorëve, pagave dhe shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe shpenzimeve komunale, kjo reformë do të ndikojë në uljen e shpenzimeve nga buxheti i Kosovës.<sup>8</sup> Reforma në administratë publike është gjithashtu njëra ndër kushtet për ndihmën buxhetore sektoriale me vlerë prej 25 milionë euro të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian.<sup>9</sup> Në funksion të rritjes së llogaridhënies është edhe draftimi i Projektligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura.<sup>10</sup>

5 Institutit GAP, Madhësia e Administratës Publike në Kosovës, Burimi: <http://bit.ly/2vOyg4J>

6 Për detajet dhe supozimet e kalkulimit shih Aneksin 1

7 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViiP>, Faqe 12


8 Ministria e Administratës Publike, Draft koncept dokument për valën e parë të racionalizimit dhe vendosjes së vijave të llogaridhënies për agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës, Burimi: <http://bit.ly/2OsYZPC>

9 Gazeta Zyrtare, Marrëveshje financiare për IPA 2016 pjesa e dytë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Burimi: <https://bit.ly/2scOF5m>

Problem në administratë publike mbetet edhe mungesa e trajnimeve për shkak të buxhetit të vogël të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP).<sup>11</sup> Buxheti për paga i këtij institucioni është rritur rreth 23 mijë euro (18%), ndërsa numri i lejuar i punëtorëve është rritur nga 16 në 19. Buxheti i ndarë për IKAP vazhdon të mbetet i pamjaftueshëm dhe numri aktual i punëtorëve ka mbetur i pandryshuar nga viti i kaluar.<sup>12</sup>

Përveç mungesës së trajnimeve, Komisioni Evropian vazhdimisht e ka ngritur shqetësimin për mungesën e kapaciteteve në MAP për mbikëqyrjen dhe zbatimin e reformës në administratë publike. Edhe këtë vit, buxheti për numrin e të punësuarve ka mbetur i njëjtë në Departamentin për Menaxhimin e Reformës në Administratë Publike në MAP, ndërsa shpenzimet kapitale janë rritur për 180 mijë euro (56%) për projektin "Implementimi i Planit të Veprimit për Reformë të Administratës Publike në Kosovë". Këto mjete janë vazhdim nga viti i kaluar, ndërsa shpenzimet e reja për këtë vit janë zero. Përveç mungesës së buxhetit për menaxhimin e reformës, buxheti i ndarë për katër dokumentet strategjike të cilat përbëjnë kornizën e reformës në administratë publike është i pamjaftueshëm dhe planifikimi i aktiviteteve për këto strategji është jo real.<sup>13</sup>

**FIGURA 2: BUXHETI I MAP SIPAS DEPARTAMENTEVE**



2017 2018

**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

10 Ministria e Administrimit Publik, Projektligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, Burimi: <http://bit.ly/2LvojGJ>

11 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViiP>, Faqe 11,

12 Intervistë me telefon me Drejtorinë për Financa në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, 27 korrik 2018

13 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViiP>, Faqe 13





## Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Raporti i KE-së edhe këtë vit thekson nevojën e ngritjes së kapaciteteve në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Sektori për Promovimin e Investimeve vazhdon të operojë me vetëm tre persona derisa në vitin 2015, ishin 193 biznese të huaja aktive në Kosovë<sup>14</sup>. Për shkak të mungesës së kapaciteteve, KIESA si udhëheqëse e Grupit Kombëtar Koordinues për Aktin për Biznes të Vogël (SBA) ka bërë pak progres në lehtësimin dhe diversifikimin e qasjes në financa të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Kurse në anën tjetër, edhe pse është paraparë buxhet shtesë për ristrukturimin e kësaj agjencie, ky proces ende nuk ka filluar ngase është në pritje të aprovimit nga Ministria e Administratës Publike<sup>15</sup>. Po ashtu, raporti i KE-së vlerëson se Ligji për Zonat Ekonomike, që rregullon themelimin dhe financimin e zonave ekonomike, nuk është në përputhje me acquis të BE-së. KIESA nuk ka programe për zhvillimin e sektorëve specifikë, e as për modernizimin e industrisë në Kosovë.<sup>16</sup>

## Agjencia Kosovare për Standardizim

Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit, raporti i KE-së vlerëson se Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS), që operon brenda MTI-së, ka mungesë të stafit. Si rezultat i kapaciteteve të pamjaftueshme, kjo agjenci vazhdon të ketë pengesa në zgjerimin e ofrimit të shërbimeve online<sup>17</sup>. Këtë vit, buxheti për AKS-në planifikohet të ketë një ngritje për 13% dhe rritje të stafit për dy punonjës<sup>18</sup>. Instituti GAP nuk ka mundur të marrë përgjigje me shkrim nga AKS nëse rritja e buxhetit dhe stafit për vitin 2018 do të jetë i mjaftueshëm në ofrimin e shërbimeve online.

## Drejtorja e Akreditimit të Kosovës

Sipas raportit të KE-së për vitin 2018, Ligji i ri për Akreditim u konsiderua si një prej parakushteve që Kosova të nënshkruante Marrëveshjen Shumëpalëshe të Bashkëpunimit Evropian për Akreditim. Është miratuar politika dhe strategjia e akreditimit 2016-2020 për Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës (DAK), por resurset e kufizuara dhe mungesa e drejtor-it/eshës të përgjithshëm/me që prej mesit të vitit 2016 e ka vënë zbatimin e kësaj strategjie në rrezik<sup>19</sup>. Buxheti i ndarë për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit në vitin

2017 ishte 77 mijë euro, ndërsa në vitin 2018 është rritur vetëm për 1,372 euro (2%)<sup>20</sup>. Mirëpo sipas DAK-së, ngritja buxhetore është e pamjaftueshme për zbatimin e plotë të strategjisë për akreditim, duke marrë parasysh rritjen e aktiviteteve brenda këtij departamenti si dhe numrin e vogël të punonjësve. Vlen të theksohet se deri më tani, Drejtorja e Akreditimit të Kosovës ka arritur që të realizojë shumicën e aktiviteteve të saj falë mbështetjes së donatorëve të ndryshëm<sup>21</sup>.

## Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

Tek mbrojtja e konsumatorit, raporti i KE-së thekson se programi i mbrojtjes së konsumatorëve për periudhën 2016-2020 është miratuar, por mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë vazhdon të pengojë implementimin efektiv të politikave dhe koordinimin e programit të mbrojtjes së konsumatorit<sup>22</sup>. Buxheti i ndarë për Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit në vitin 2017 ishte 34.9 mijë euro, ndërsa në vitin 2018 është rritur vetëm për 1.3 mijë euro (4%)<sup>23</sup>. Mirëpo, sipas Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, objektivat që rrjedhin nga programi për tri fushat kryesore siç janë: a) harmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së; b) ngritja e kapaciteteve njerëzore tek departamenti dhe këshilli për mbrojtjen e konsumatorit; dhe c) aktivitetet e vetëdijesimit, janë vështirë të realizueshme me resurset aktuale. Departamenti nuk mund të zhvillojë aktivitete në qoftë se nuk ka staf të mjaftueshëm për t'i realizuar ato<sup>24</sup>.

## Inspektorati i Tregut

Sipas raportit të KE-së, Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregjeve është pjesërisht i përafuar me acquis, megjithatë, numri i pamjaftueshëm i inspektorëve dobëson kapacitetin e mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve. Buxheti i ndarë për Inspektoratin e tregut për vitin 2017 ishte 224.5 mijë euro, ndërsa në vitin 2018 është rritur për 40.6 mijë euro (18%)<sup>25</sup>. Kjo rritje ka shkuar krejtësisht për paga dhe mëditje. Krahasuar me vitin 2017, numri i lejuar i të punësuarve është rritur për pesë persona. Në vitin 2017 ishin gjithsej 27 të punësuar, ndërsa në vitin 2018 gjithsej 32 të punësuar. Mirëpo, sipas Inspektoratit të Tregut, duke marrë parasysh numrin e madh të ligjeve të cilat janë në kompetencë të inspektoratit të tregut, ngritja buxhetore dhe ngritja e numrit të punonjësve është e mirëseardhur por e pamjaftueshme në zbatimin e plotë të ligjeve në fuqi<sup>26</sup>.

14 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM4 2017. Burimi: <https://bit.ly/2MpfzSh>

15 MTI, Përgjigje me shkrim, 28 qershor 2018.

16 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViIP>, Faqe 67,

17 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViIP>, Faqe 51,

18 Kuvendi i Kosovës, Projekligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>

19 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViIP>, Faqe 51,

20 Kuvendi i Kosovës, Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>

21 MTI, Përgjigje me shkrim, 28 qershor 2018.

22 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViIP>, Faqe 62,

23 Kuvendi i Kosovës, Projekligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>

24 MTI, Përgjigje me shkrim, 28 qershor 2018.

25 Kuvendi i Kosovës, Projekligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>

26 MTI, Përgjigje me shkrim, 28 qershor 2018.


## Agjencioni i Metrologjisë së Kosovës

Raporti i KE-së thekson se tek metrologjia, baza ligjore për rregulloret teknike, standardet, vlerësimin e konformitetit si dhe akreditimin është pjesërisht e përafuar me acquis<sup>27</sup>. Si rezultat, nevojitet punë në legjislacionin aktual të metrologjisë. Po ashtu, organet e vlerësimit të cilësisë, standardeve dhe akreditimit vlerësohen se kanë staf dhe burime financiare të kufizuara, gjë që i pengon ato në implementim të plotë të acquis. Me buxhetin e planifikuar për vitin 2018, Agjencionit të Metrologjisë i është rritur numri i lejuar i stafit për dy persona në krahasim me vitin e kaluar dhe tani ka rreth 1% më pak buxhet.

## Agjencia e Pronës Industriale

Sipas raportit të KE-së, edhe pse Agjencia Shtetërore e Pronës Intelektuale dhe Agjencia e Pronës Industriale kanë bërë progres në harmonizimin e legjislacionit me acquis të BE-së, ende ka nevojë për më shumë fonde, staf e trajnim në implementimin e tyre. Zbatimi i legjislacionit që përfshin mjetet efektive për ushtrimin e të drejtave pronësore intelektuale, të cilat janë në pajtim me obligimet e MSA-së, vazhdojnë të mbesin vështirë të realizueshme për shkak të mungesës së resurseve financiare dhe njerëzore. Buxheti i ndarë për Agjencinë për Pronësi Industriale në vitin 2017 ishte 123.4 mijë euro, ndërsa në vitin 2018 bie për 7.4 mijë euro (-6%). Kjo rënie është si rezultat i shpenzimeve kapitale, të cilat në vitin 2017 ishin 30 mijë euro, ndërsa tani janë zero<sup>28</sup>. Prandaj, ky buxhet nuk adreson nevojat e këtyre agjencive në zbatimin e ligjeve në fuqi<sup>29</sup>.

**FIGURA 3: BUXHETI NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TE MTI SIPAS DEPARTAMENTEVE**




**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

27 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZVilP>, Faqe 50,

28 Kuvendi i Kosovës, Projekligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6E>

29 MTI, Përgjigje me shkrim, 28 qershor 2018.

**FIGURA 4: NUMRI I PUNËTORËVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË MTI SIPAS DEPARTAMENTEVE**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

## Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Sipas raportit të KE-së për vitin 2018, Autoriteti i Konkurrencës i ka 13 zyrtarë por me ekspertizë të kufizuar në zbatimin e legjislacionit. Ekipit i mungon trajnimi i përshtatshëm për konkurrencën dhe përbashkimet. Buxheti ka qëndruar stabil, por i pamjaftueshëm. Instituti GAP nuk ka mundur të marr përgjigje nëse rritja e buxhetit për vitin 2018 për 79.4 mijë euro (31%) do të plotësojë kërkesat e këtij autoriteti.




## Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)

Raporti i KE-së edhe këtë vit ka kritikuar politizimin e ZRRE-së. Po ashtu, ky raport ka vlerësuar se pak progres është arritur në zbatimin e pakos së tretë të energjisë, de-rregullimin e pjesshëm të çmimit të gjenerimit dhe largimin e subvencioneve të tërthorta mes kategorive të ndryshme të konsumatorëve<sup>30</sup>. Kapacitetet e dobëta administrative dhe mungesa e burimeve njerëzore shihen si problematike në adresimin e problemeve të këtij agjencioni.

Buxheti për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë në vitin 2017 ishte 768.3 mijë euro, ndërsa në vitin 2018 arrin në 784.3 mijë euro, apo 16 mijë euro më shumë se vitin e kaluar<sup>31</sup>. Pagat dhe mëditjet janë rritur për 16 mijë euro (3%) ndërsa numri i punonjësve ka mbetur i njëjtë. Sipas ZRRE-së, ngritja e buxhetit për paga dhe mëditje vjen si pasojë e njohjes së përvojës së punës të stafit të ZRRE-së. Ndërkaq, pavarësia buxhetore vazhdon të mbetet si problemi kyç në përmbushjen e obligimeve që dalin nga pakoja e tretë e ligjeve të energjisë për hapjen e tregut si dhe në pjesëmarrjen e ZRRE-së në aktivitetet ndërkombëtare. Sipas tyre, ZRRE vazhdimisht është mbështetur nga donatorët në ofrimin e ndihmës këshilluese ngase buxheti aktual është i pamjaftueshëm<sup>32</sup>.

**FIGURA 5: BUXHETI I ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË**




**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

## Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE)

Sa i përket eficiencës së energjisë, raporti i KE-së vlerëson pak arritje në këtë drejtim. Plani i veprimit të tretë për eficiencën e energjisë që parasheh arritjen e caktuar prej 9% duket vështirë i realizueshëm. Mungesa e krijimit të Fondit të Eficiencës së Energjisë ka vonuar investimet në masa të eficiencës në sektorin publik dhe atë privat. Për më tepër, Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë ka staf dhe kapacitete të pamjaftueshme për të monitoruar, vlerësuar e verifikuar ecurinë e cagueve.

Buxheti për Agjencionin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në vitin 2017 ishte 5 milionë euro, ndërsa në vitin 2018 arrin në rreth 7 milionë euro, apo rreth 2 milionë euro më shumë se vitin e kaluar. Shpenzimet kapitale janë rritur për afro 1.8 milionë euro ndërsa numri i punëtorëve mbetet i njëjtë. Edhe për këtë agjencion, Instituti GAP nuk ka arritur të marrë ndonjë përgjigje nëse rritja e buxhetit për vitin 2018 do të plotësojë nevojat e këtij autoriteti.

**FIGURA 6: BUXHETI I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

30 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZVilP>, Faqe 73,

31 Kuvendi i Kosovës, Projekligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6F>


32 ZRRE, Përgjigje me shkrim, 05 korrik 2018.



## Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë

Sipas raportit të KE-së për vitin 2018, sa i përket bujqësisë, buxheti prej 46 milionë euro për grante dhe pagesa direkte ka mbetur i njëjtë. Mirëpo, Agjencia për Zhvillim Bujqësor (AZhB) vazhdon të ketë probleme me adresimin e kërkesave dhe ekzekutimin e pagesave për bujqit. E gjithë kjo, në masë të madhe po shkaktohet si pasojë e mungesës së stafit për të bërë monitorimin, vlerësimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm. Buxheti i ndarë për AZhB-në për vitin 2017 ishte 520.8 mijë euro. Ndërsa, në vitin 2018 është rritur për 90.5 mijë euro (17%). Pagat dhe mëditjet janë rritur për 71.9 mijë euro (20%). Krahasuar me vitin e kaluar numri i lejuar i të punësuarve është rritur për dy persona. Instituti GAP nuk ka arritur të marr ndonjë përgjigje nëse rritja e buxhetit dhe punonjësve për vitin 2018 do të plotësojë nevojat e këtij agjencioni.

**FIGURA 7: BUXHETI I AGJENCIONIT PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË**




**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

## Transporti

Sipas raportit të KE-së të vitit 2018, sa i përket politikave të transportit, duhet të miratohet legjislacioni për Sistemin Inteligent të Transportit (ITS), të definohet korniza strategjike për implementimin e ITS-së në rrjetet themelore, dhe të sigurohen kapacitete e resurse të mjaftueshme për zbatimin e tij. Buxheti për Ministrinë e Infrastrukturës në vitin 2017 ishte rreth 279,9 milionë euro, ndërsa në vitin 2018 ka pasur rënie rreth 31.8 milionë euro (-11%). Këtë rënie e ka shkaktuar ulja e shpenzimeve kapitale për 32.664,58 euro (-12%). Ngritje ka pësuar kategoria e mirëmbajtjes së rrugës ku në vitin 2017 ishin shpenzuar 9 milionë e 366 mijë euro ndërsa në vitin 2018 më shumë se 10 milionë euro. Krahasuar me vitin 2017, MI ka punësuar dy persona më shumë gjithsej 298 punonjës<sup>33</sup>.

**FIGURA 8: BUXHETI I MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

<sup>33</sup> Kuvendi i Kosovës, Projekligji për buxhetin e Republikës së Kosovës 2018, Burimi: <http://bit.ly/2o0Mf6E>

# Shëndetësia dhe mjedisi






Raporti i KE-së i sheh si brengosëse shpenzimet e ulëta publike në shëndetësi. Sipas një vlerësimi në vitin 2016, nevojat e përgjithshme vjetore për shëndetësi u përmbushën vetëm 40%. Shumica e shpenzimeve publike (rreth 68%) mbulojnë kostot fikse, kurse pjesa tjetër është për kosto të pacientëve për trajtim, parandalim, dhe diagnostifikim. Raporti kritikon edhe llogaridhënien institucionale dhe mungesën e një strategjie për të rritur produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë në këtë sektor. Shpenzimet që bëjnë për shëndetësi, qytetarët e vendeve si Kosova (40%),<sup>34</sup> Shqipëria (49.9%) apo Mali i Zi (42.8%) nga xhepi i tyre, si përqindje e shpenzimeve totale për shëndetësi në vend, llogariten të jenë rreth dyfishi i asaj që shpenzojnë qytetarët e Bashkimit Evropian.<sup>35</sup>

Buxheti i planifikuar për vitin 2018 është 65.53 milionë euro apo rreth 22% më i lartë se në vitin 2017. Në vitin 2018, shuma e ndarë për sektorin e shëndetësisë nga qeveria është mbi 10% e buxhetit total vjetor apo rreth 3% e BPV-së.<sup>36</sup> Ngjashëm si Kosova, Qeveria e Shqipërisë ndan buxhet për sektorin e shëndetësisë që është i përafërt me rreth 3% të BPV-së së saj vjetore.<sup>37</sup> Nga vendet në rajon dhe Ballkan që shpenzojnë më shumë për këtë kategori janë Bosnja (7%), Sllovenia (7%), Serbia (6%) dhe Serbia (6%).

**FIGURA 9: BUXHETI I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**




**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

## Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit

Sa i përket mjedisit, raporti i KE-së thekson nevojën e Kosovës në përafrimin e legjislacionit me direktivat e BE-së si dhe në zbatimin e tyre. Mungesa e zbatimit të Direktivës për Përgjegjësinë Mjedisore pengon mbrojtjen e mjedisit. Inspektorët mjedisor kanë mungesë të stafit dhe kapaciteteve që të garantojnë zbatimin e Krimit Mjedisor. Po ashtu, financimi i pamjaftueshëm, mungesa e kapaciteteve administrative si dhe e aftësive teknike po dëmtojnë edhe zbatimin e masave prioritare.

Buxheti për Departamentin e Mjedisit në vitin 2017 ishte rreth 852 mijë euro, ndërsa në vitin 2018 arrin në 2.2 milionë euro, apo rreth 1.4 milionë euro më shumë se vitin e kaluar. Nga kjo rritje pagat dhe mëditje janë rritur për 17.7 mijë euro ndërsa shpenzimet kapitale për 1.3 milionë euro. Numri i stafit në vitin 2018 është planifikuar të ngritet për dy punonjës. Instituti GAP nuk ka mundur të marrë përgjigje nga departamenti për mbrojtjen e mjedisit e cila është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor nëse kjo ngritje e buxhetit dhe numrit të punonjësve mjafton për t'i realizuar obligimet e këtij departamenti.

**FIGURA 10: BUXHETI I DEPARTAMENTIT TË MJEDISIT**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

34 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>.

35 Ekonomisti, Njësia e Intelegjencës. Modernizimi i sistemeve shëndetësore në ballkan. Burimi: <https://bit.ly/2JyJwKd>.

36 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për buxhetin 2018. Burimi: <https://bit.ly/2L6eBKH>.

37 Ministria e Financave të Shqipërisë. Programi për Reforma Ekonomike 2018-2020. Burimi: <https://bit.ly/2mt1lf2>.

## Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore

Raporti i KE-së ka ngritur shqetësim për pabarazinë gjinore në parlament, në parti politike dhe numrin e ulët të grave deputete dhe kandidateve për kryetare komunash sikurse u pa gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe lokale. Në Kosovë, vetëm 32.5% e deputetëve janë gra si dhe nga 204 kandidatë për kryetare komunash, vetëm tetë ishin gra. Mbështetja financiare nga partitë politike për kandidatët burra është shumë më e lartë se për kandidatet gra si dhe mediat u dhanë përparësi mbulimit të programeve të politikanëve burra.<sup>38</sup>

Në lidhje me financat e partive politike, raporti i KE-së thotë se financimi i fushatave elektorale dhe shpenzimet vazhdojnë të mos jenë transparente duke mos zbatuar kështu legjislacionin përkatës. Kjo zvogëlon besimin e qytetarëve në partitë politike dhe vazhdon të rrisë mundësitë e korrupsionit dhe ndikimit të panevojshëm politik. Një hap pozitiv konsiderohet publikimi i auditimeve të jashtme të financave të partive politike që u bë për herë të parë para pesë vitesh.<sup>39</sup>


38 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>, faqe 7

39 Ibid. faqe 8

## Prokuroria dhe gjyqësori

Për të adresuar sfidat e lartpërmendura vazhdimisht përmendet nevoja për rritje të kapaciteteve profesionale, buxhetit si dhe digjitalizimit të rasteve. Në vitin 2018, buxheti për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) është 23.5 milionë euro, apo 2.4 milionë euro (11.5%) më shumë se një vit më herët. Në KGJK pritet të rritet numri i personelit për 112 persona, ku në total do të jenë 2,271 punëtorë gjatë vitit 2018.<sup>40</sup> Ndërkaq, buxheti i ndarë për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) është afro 11.1 milionë euro, apo 2.4 milionë euro (27.3%) më shumë se në vitin 2017. Rritja më e madhe e buxhetit në 2018 ishte në kategorinë e investimeve kapitale, shumica e të cilave reflektohen në projektet kapitale për ndërtimin e objektit të ri të KPK-së dhe mjete të transportit, por pjesë më të vogla do të alokohen edhe në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)-TIK i cili bashkë financohet nga qeveria norvegjeze. KPK parashihet të ketë 846 punëtorë në 2018.<sup>41</sup>

**FIGURA 11: BUXHETI I KGJK-SË DHE KPK-SË PËR 2018**



Sipas KGJK-së, rritja e buxhetit do të ndikojë në zgjidhjen e lëndëve të vjetra nëpër gjykata si dhe përsheptimin e zgjidhjes së lëndëve aktuale duke rritur kështu efikasitetin e gjyqësorit. Personeli i ri do të angazhohet në të gjitha departamentet e gjykatave sipas nevojave dhe strategjisë për zgjidhje të lëndëve. Po ashtu, rastet e korrupsionit janë tanimë të regjistruara në programet e teknologjisë informative dhe nuk ka pasur nevojë për buxhet shtesë. Edhe pse numri i gjyqtarëve në departamentin administrativ është rritur, numri i gjyqtarëve të angazhuar në Departamentin për çështje ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë mbetet pesë, edhe pse do të duhej të rritej, meqenëse kjo çështje është ngritur si problematikë për vite me radhë.<sup>42</sup>

**TABELA 1: TË PUNËSUARIT NË KGJK 2017 VS. 2018**

Institucioni	Stafi 2018	2017R	2017	Stafi '18 vs. '17
Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme	96	93	93	3
Sekretariati i KGJK-së	122	87	87	35
Njësia e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore	7	7	7	0
Zyra e Prokurorit Disiplinor	26	20	20	6
Gjykata e Apelit	139	132	132	7
Gjykata Themelore në Prishtinë	504	479	479	25
Gjykata Themelore në Prizren	233	226	226	7
Gjykata Themelore në Gjilan	220	214	214	6
Gjykata Themelore në Ferizaj	178	173	173	5
Gjykata Themelore në Pejë	237	231	231	6
Gjykata Themelore në Gjakovë	165	160	160	5
Gjykata Themelore në Mitrovicë	344	337	337	7
<b>Totali</b>	<b>2,271</b>	<b>2,159</b>	<b>2,159</b>	<b>112</b>

**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

40 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për buxhetin 2018. Burimi: <https://bit.ly/2L6eBKH>

41 Ibid.

42 Instituti GAP, Pyetësor me institucionet përgjegjëse për sundim të ligjit. Maj 2018

Veç kësaj, alokimi i rasteve tek gjyqtarët në mënyrë të rastësishme përmes sistemit të veçantë të teknologjisë informative ende nuk është duke u zbatuar në plotni. KGJK raporton se regjistrimi i lëndëve në këtë sistem ka filluar dhe janë bërë disa teste preliminare për të analizuar funksionimin e këtij sistemi.<sup>43</sup> Ligji për buxhet i vitit 2018 nuk parasheh buxhet për investime kapitale në këtë drejtim, por vetëm për dizajnimin e ndërtimin e gjykatave themelore dhe një shumë e vogël i ndahet furnizimit me kompjuterë, fotokopje e pajisje të ngjashme.<sup>44</sup>


Edhe për KPK-në, rritja e buxhetit do të ndihmojë në rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesional, mundësisë për trajnime shtesë për vepra sikurse terrorizmi, krimi i organizuar e të ngjashme, qasje më të madhe në drejtësi për qytetarët përmes publikimit të buletineve informativ dhe formave të tjera të komunikimit si dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të teknologjisë informative.<sup>45</sup>

Rritja e buxhetit për Këshillin Prokurorial në mënyrë të drejtpërdrejtë mundëson që prokurorët të merren vetëm me raste të reja dhe të kenë mundësi që të përgatiten më mirë hetimi dhe ndjekja e kryesëve të veprave penale, respektivisht të avancohet profesionalizmi në sistemin prokurorial. Pesë prokurorë do të caktohen në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe pjesa tjetër do të shpërndahen në kuadër të prokurorive themelore bazuar në nevojat specifike të prokurorive.

## Lufta kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit

Çështje tjetër e ngritur vazhdimisht është edhe mungesa e specializimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policëve në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë konfiskimin e pasurisë dhe pastrimin e parave.<sup>46</sup> Akademia e Drejtësisë (AD), më parë e njohur si Instituti Gjyqësor i Kosovës, që mandat kryesor e ka trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës, ka buxhet afro 800 mijë euro, që përbën një rritje prej 25% nga viti i kaluar, megjithëse numri i lejuar i punëtorëve vazhdon të mbetet 25.<sup>47</sup>

**FIGURA 11: BUXHETI I AKADEMISË SË DREJTËSISË (AD) 2017 VS. 2018**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë konfirmojnë se trajnimet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit organizohen në vazhdimësi. Sa i përket programit për trajnime të vazhdueshme gjatë këtij viti, janë paraparë tri sesione trajnimi me kohëzgjatje dy ditore si dhe dy trajnime një ditore. Trajnimet e deritanishme janë organizuar për ngritjen e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit si dhe forcimin e kapaciteteve për hetime penale kundër korrupsionit me partnerët e drejtësisë në rajonin e Mitrovicës.<sup>48</sup> Për më tepër, kërkesat buxhetore të AD-së nuk janë miratuar, prandaj buxheti aktual nuk garanton realizimin e të gjitha trajnimeve të parapara gjatë vitit 2018. Prandaj, planifikohet mbështetje edhe nga donatorët.<sup>49</sup>

Komisioni Evropian thekson se hetimet financiare nuk janë nisur sistematikisht në rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ende nuk ekziston një sistem efikas për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pronës së zyrtarëve të lartë publik dhe të dhuratave për të gjithë zyrtarët publikë. Financimi i pamjaftueshëm ka penguar seriozisht zbatimin e strategjisë kundër-korrupsionit 2013-2017.<sup>50</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit, si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve publik, përballet gjithashtu me probleme buxhetore. Meqenëse Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit 2018 – 2022 nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, AKK nuk ka kërkesë buxhetore për vitin 2018, por konsideron se pasiqë Qeveria ka miratuar planin e veprimit dhe strategjinë e re, AKK do ta ketë më të lehtë ta zbatojë atë.<sup>51</sup>

43 Ibid.

44 Ministria e Financave, Ligji nr. 06/I-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Burimi: <https://bit.ly/2ndVsbl>

45 Ibid.

46 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>, faqe 21

47 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për buxhetin 2018. Burimi: <https://bit.ly/2L6eBKH>

48 Instituti GAP, Pyetësor me institucionet përgjegjëse për sundim të ligjit. Maj 2018


49 Ibid.

50 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>, faqe 21

51 Instituti GAP, Pyetësor me institucionet përgjegjëse për sundim të ligjit. Maj 2018

Edhe kapacitetet për hetimin e rasteve të korrupsionit dhe kërkit të organizuar konsiderohen të pamjaftueshme. Rastet e korrupsionit për momentin trajtohen nga prokurorët e departamentit të krimeve të rënda dhe të departamentit të përgjithshëm përfshirë dhe prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). Në PSRK, aktualisht janë 13 prokurorë dhe kryeprokurori i kësaj prokurorie, ndërsa është në proces të plotësimit të numrit me prokurorë në këtë prokurori. Ndërkaq, Prokuroria Themelore e Prishtinës ka njësitin e veçantë për luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit ku ushtrojnë detyrën shtatë prokurorë. Përveç mungesës së prokurorëve, problem konsiderohet edhe mungesa e ekspertëve të fushave të ndryshme si staf mbështetës i prokurorëve.<sup>52</sup>

**FIGURA 12: BUXHETI I AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONI (AKK) 2017 VS. 2018**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

## Migracioni dhe azili

Në raportin e KE-së kritikohet numri i ulët i stafit të disa divizioneve të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme përkundër rritjeve në staf vitet e fundit. Përfaqësues të MPB-së theksojnë se për vitin 2018 janë paraparë të rekrutohen pesë punëtorë në këtë departament. Po ashtu, sipas Rregullores, MPB ka vende të lira punë, por sipas buxhetit të Kosovës për këtë vit, ka mungesë të mjeteve financiare krahasuar me numrin e aprovuar të punëtorëve për vitin 2018.

**TABELA 2: TË PUNËSUARIT DHE BUXHETI NË MPB 2018**

Departamenti	Punëtorë	Paga dhe Mëditje (në Euro)	Mallra dhe Shërbime (në Euro)	Shpenzime Komunale (në Euro)	Investime Kapitale (në Euro)	Subvencione dhe Transfere (në Euro)	Gjithsej
Zyra e Ministrit	19	236,876	45,885	-	-	-	282,761
Shërbimet e Administratës Qendrore	143	1,028,049	731,583	120,300	1,025,542	27,000	2,932,474
Agjencioni i Regjistrimit Civil	666	4,496,489	6,419,389	169,600	1,404,316	-	12,489,794
Agjencioni për Menaxhimin Emergj.	175	1,193,050	421,407	37,320	1,493,500	-	3,145,277
Riintegrimi i Personave të Riatdhes.	23	157,658	908,679	93,000	-	1,725,497	2,884,834
Agjencia e Kosovës për Forenzikë	53	643,545	395,303	42,000	500,000	741	1,581,589

**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018


<sup>52</sup> Instituti GAP, Pyetësor me institucionet përgjegjëse për sundim të ligjit. Maj 2018



Aktualisht, Kosova shpenzon më së paku në rajon për veprimtari kërkimore-shkencore. Përkundër që Ligji për veprimtari kërkimore-shkencore përcakton se 0.7% e buxhetit vjetor duhet të ndahet për këtë fushë,<sup>53</sup> në vitin 2015 ishin ndarë vetëm 0.19% e buxhetit (0.05% e BPV-së),<sup>54</sup> kurse në vitin 2016 rreth 0.33% e buxhetit (0.1% e BPV-së).<sup>55</sup> Të gjitha vendet fqinje qëndrojnë më mirë se Kosova në këtë aspekt, pasi që ndajnë rreth 0.9% të BPV-së për këto veprimtari. Kurse, në rajon, Sllovenia është shteti që investon më së shumti në këtë fushë – më shumë se Greqia, Kroacia dhe Bullgaria - me mbi 2% të BPV-së në vit.

Mirëpo, kjo shifër e ulët e Kosovës për veprimtari kërkimore-shkencore krahasuar me vendet tjera, pritet të ndryshojë sidomos gjatë vitit 2018. Kjo, për shkak se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e themeluar në 2017, ka dizajnuar programet<sup>56</sup> për mbështetjen financiare të OJQ-ve, start up-ëve dhe Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla të cilat kategorizohen si veprimtari kërkimore-shkencore në Ligjin për veprimtari kërkimore-shkencore (neni 5).

**FIGURA 12: SHPENZIMI PËR VEPRIMTARI KËRKIMORE-SHKENCORE SI PËRQINDJE E BPV-SË**



**Burimi:** Instituti GAP, bazuar në të dhënat e UNESCO57

Sa i përket shpenzimit të Qeverisë së Kosovës në edukim dhe aftësim, raporti i KE-së 2018 kritikon menaxhimin dhe efektivitetin e tij për ngritjen e cilësisë në arsim në vitin 2017. Mirëpo, edhe në buxhetin 2018, shkurtim buxhetor kanë pësuar dy nën programe vitale në fushën e arsimit, ajo për trajnimin e mësuesve, që në 2018 ka buxhet më të vogël se në 2017 për 46%, dhe ajo për zhvillimin e plan programit në arsimin para universitar, që në 2018 ka buxhet më të vogël për 29%. Në vitin 2017, Kosova u rendit e fundit në rajon dhe nga pesë të fundit në botë nga vlerësimi ndërkombëtar në fushën e arsimit, PISA, ku nxënësit 15 vjeçar performuan shumë dobët në të gjitha lëmitë. Andaj, qeveria do të duhej të rrisë shpenzimet për programet si këto më lartë që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

53 Kuvendi i Kosovës. Ligji për veprimtari kërkimore-shkencore. Burimi: <https://bit.ly/2NUakl9>.

54 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016. Report. Burimi: <https://bit.ly/2INRfCI>.

55 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018 Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>.

56 Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Burimi: <https://bit.ly/2uI9Tz>.

57 Për Kosovën të dhënat janë marrë nga Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën 2017-2018 dhe Buxheti i Kosovës 2016-2017. Ndërsa, për Shqipërinë, të dhënat janë marrë nga Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016.






Radio Televizioni i Kosovës, edhe këtë vit, ka mbetur nën financimin e buxhetit të shtetit. Sipas ligjit për buxhetin, RTK-së këtë vit do t'i ndahen rreth 11 milionë euro nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.<sup>58</sup> Megjithëse afati ligjor për gjetjen e financimit të qëndrueshëm të RTK-së ka kaluar në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka miratuar një ligj të ri për transmetuesin publik, me anë të së cilit do të adresonte këtë problem. Instituti GAP ka kërkuar që RTK të financohet direkt nga parapaguesit, ndërsa kërkesat për fonde për investime në teknologji apo në fushën e digjitalizimit do të mund të bëheshin përmes plan-projekteve të veçanta dhe sipas kërkesave, të drejtuara qoftë në institucionet vendore apo ato të Bashkimit Evropian.

Sipas interpretimit të Komisionit Evropian për financimin e transmetuesve publik, forma aktuale e ndihmës shtetërore e cila favorizon direkt vetëm një transmetues, dëmton konkurrencën. Në rast se vazhdohet me opsionin e dhënies së ndihmës shtetërore nga buxheti i shtetit, atëherë sipas rregullave të BE-së: i) parametrat mbi të cilat është kalkuluar ndihma shtetërore duhet të vendosen paraprakisht dhe të bëhen transparent; ii) kompensimi nuk duhet të tejkalojë koston e tërësishme apo të pjesërishme për realizimin e obligimeve të transmetuesit publik; iii) në rast se kompensimi nuk bëhet përmes procedurave të konkurrimit me prokurim publik, kosto e kompensimit duhet të caktohet duke analizuar kostot që një transmetues, i pajisur me teknologji të përshtatshme dhe që i plotëson kërkesat për këtë shërbim publik, do të kërkonte për realizimin e obligimeve programore të një transmetuesi publik.<sup>59</sup>

Për shkak të vështirësive për të mbuluar shpenzimet financiare, duke përfshirë edhe ato nga investimet kapitale, probleme buxhetore ka edhe Komisioni i Pavarur i Mediave.<sup>60</sup> Edhe këtë vit nuk është ndarë buxhet për investime kapitale për këtë institucion, ndërsa buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 62 mijë euro (13%). Megjithëse numri i lejuar i punëtorëve është rritur nga 31 në 37, sipas Komisionit Evropian ky institucion ka nevojë për staf shtesë në mënyrë që të realizojë misionin e tij.<sup>61</sup>


**FIGURA 13: BUXHETI I KPM-SË SIPAS KATEGORIVE BUXHETORE**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Sikurse viteve të kaluara, Komisioni Evropian ka konstatuar prapë së Agjencia e Statistikave të Kosovës ka mungesë të kapaciteteve njerëzore për realizimin në kohë të publikimeve dhe sigurimin e cilësisë së statistikave. Krahasuar me rishikimin e buxhetit të vitit 2017, buxheti në vitin 2018 është rritur për 264 mijë euro (27%), ndërsa numri i lejuar i punëtorëve është rritur për 10 persona. Sipas ASK-së, kjo ngritje do t'i mundësojë që të prodhojë më shumë statistika, megjithatë nuk është e mjaftueshme. Kërkesat e ASK-së për buxhet kanë qenë për 810 mijë euro më të larta, krahasuar me buxhetin e miratuar.<sup>62</sup>

**FIGURA 14: BUXHETI I AGJENCISE SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS SIPAS KATEGORIVE**



**Burimi:** Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

58 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për buxhetin 2018. Burimi: <https://bit.ly/2L6eBKH>

59 EUR-Lex, Komunikimi i Komisionit mbi aplikimin e rregullave të ndihmës shtetërore në transmetimet publike, Burimi: <http://bit.ly/2KmgFJd>

60 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZVilP>, Faqe 23

61 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZVilP>, Faqe 74

62 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Përgjigje me email, 30 korrik 2018

# Buxhetet komunale

Nga problemet financiare me të cilat përballen komunat është mungesa e buxhetit për kompetencat e deleguara nga niveli qendror në nivel lokal. Një nga këto kompetenca është edhe ofrimi i shërbimeve sociale. Për arsye se Ligji për financat e pushtetit lokal, nuk e ka të përfshirë grantin për shërbime sociale si pjesë e granteve operative, nga viti 2009 buxheti për shërbime sociale është ndarë si pjesë e grantit të përgjithshëm për komuna. Duke qenë pjesë e grantit të përgjithshëm, ndarja e fondeve për shërbime sociale është në diskrecion të komunave dhe për këtë arsye shpenzimet për çështje sociale ndonjëherë nuk i plotësojnë madje as standardet minimale.<sup>63</sup>

Ministria e Financave ka themeluar grupin punues për hartimin e Projektligjit të ri për financat e pushtetit lokal dhe ka hartuar draftin e konceptit për financat e pushtetit lokal përmes të cilit do të adresohet edhe problemi i grantit për shërbime sociale.<sup>64</sup> Në parim, MF dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) janë pajtuar që ky

grant të jetë një grant specifik për komuna, ashtu sikurse granti për arsim dhe shëndetësi. Duke marrë parasysh këtë, ky grant do të shpenzohet vetëm për çështjet e shërbimeve sociale. Ky grant gjithashtu pritet të jetë i hapur, gjë që lë hapsirë për rritjen e tij varësisht nga standardet e BE-së të cilat do t'i implementojë shteti i Kosovës. Fondet për financimin e këtij granti pritet të ndikojnë në uljen e grantit të përgjithshëm për komuna.<sup>65</sup>

Problem tjetër sa i përket komunave është edhe realizimi i planeve për investime kapitale. Në vitin 2017, komunat kanë realizuar vetëm 75% të buxhetit për shpenzime kapitale. Vonesa në shtyrjen e investime kapitale shkakton edhe mungesa e realizimit të planit për të hyra vetanake.<sup>66</sup> Për shembull, nga tatimi në pronë, si një nga burimet kryesore të të hyrave vetanake komunale, komunat e kanë mbledhur vetëm 43% të të hyrave të faturuara.<sup>67</sup>



63 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViiP>, Faqe 60

64 Ministria e Financave, Vendim 93-1/2018, Datë 02.07.2018

65 Instituti GAP ka qenë pjese e grupit punues për Hartimin e Draftkoncept dokumentit për financat e pushtetit lokal

66 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <http://bit.ly/2uZViiP>, Faqe 40

67 Zyra Kombëtare e Auditimit, Tregues performance për nivelin lokal qeverisës për vitin 2017, Burimi: <http://bit.ly/2KFT6uZ>

# Përfundime dhe rekomandime

Në këtë raport kemi identifikuar rekomandimet e Komisionit Evropian për Kosovën në raport me ndarjet buxhetore për vitin 2018. Të gjeturat tona tregojnë se ka pasur rritje të buxhetit për disa institucione/fusha për të cilat ka rekomanduar KE, mirëpo kjo rritje mbetet e pamjaftueshme. Negative është rritja e numrit të ministrive dhe fragmentimi i institucioneve të pavarura sepse kanë rritur shpenzimet rrjedhëse buxhetore dhe njëkohësisht është duke penguar kohezionin në vendimmarrje. Buxheti për rend dhe siguri publike është rritur krahasuar me vitin e kaluar, mirëpo duhet buxhet i shtuar për trajnim të prokurorëve dhe gjyqtarëve, financim të strategjisë kundër-korrupsion dhe në përgjithësi rritje e kapaciteteve për luftën ndaj korrupsionit.

Sa i përket zhvillimit të tregut dhe arsimit, shpenzimet në arsim dhe hulumtime mbesin ndër më të ulëtat në rajon. Ka pasur një rritje të buxhetit tek institucionet që merren më zhvillimin e tregut në kuadër të MTI-së, mirëpo buxheti për disa nga këto institucione mbetet i pamjaftueshëm. Në anën tjetër, shqetësuese mbetet funksionimi i ZRRE-së për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm. Gjithashtu, me gjithë rritjen e buxhetit për Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, ende nuk është themeluar fondi për eficiencë të energjisë.

Megjithë rritjen e buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë, ndarja e buxhetit për këtë sektor është e pamjaftueshme. Edhe sa i përket çështjeve sociale, për shkak të rregullimit të dobët ligjor, financimi i shërbimeve sociale nga komunat është i ulët. Sa i përket çështjeve mjedisore, ka pasur një ngritje të buxhetit mirëpo nuk kemi arritur të marrim një përgjigje nga MMPH nëse ky buxhet është i mjaftueshëm.

Probleme të financimit ka edhe në fushën e medieve dhe statistikave. Ashtu sikurse vitet e kaluar, ende nuk është siguruar një formë e qëndrueshme e financimit për RTK-në, ndërsa mungesë e buxhetit është cilësuar të ketë edhe KPM dhe ASK.

Duke marrë parasysh këto të gjetura, Instituti GAP rekomandon:

- Qeveria duhet të procedojë Projektligjin për Qeverinë sipas Programit Legjislativ 2018. Ligji për Qeverinë duhet të përmbajë rregulla që përcaktojnë nevojën dhe procedurën e krijimit të ministrive të reja;
- MAP dhe Qeveria e Kosovës të vazhdojnë procesin e kalimit të agjencive nga menaxhimi i Kuvendit të Kosovës në menaxhim të ministrive përkatëse;
- Të ndahet buxhet i mjaftueshëm për trajnime në administratë publike dhe zbatim të strategjive të cilat prekin reformën në administratë;
- Të rritet stafi dhe kapacitetet për Sektorin e Promovimit të Investimeve të Huaja në KIESA, në mënyrë që të rritet numri dhe cilësia e shërbimeve për investitorët e huaj;
- Të rritet buxheti për institucionet kyçe të cilat sigurojnë funksionimin e tregut të lirë siç janë: Drejtoria e Akreditimit të Kosovës, Agjencia Kosovare për Standardizim, Inspektorati i tregut, Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit; dhe Agjencioni për Metrologji;
- Të themelohet fondi për eficiencë të energjisë dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për Agjencionin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në kuadër të MZHE-së;
- Të miratohet ligji i ri për RTK-në i cili i siguron qëndrueshmëri financiare dhe njëkohësisht në këtë ligj të përcaktohen rregullat në rastet kur duhet të financohet RTK nga buxheti i shtetit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që fondet publike shpenzohen në mënyrë efikase dhe nuk dëmtojnë konkurrencën mediale;
- MF të hartojë draftin e ri të Ligjit për financimin e pushtetit lokal, me anë të të cilit financimi i këtyre shërbimeve sigurohet me grant specifik, në mënyrë që të përmirësohet baza ligjore për financimin e shërbimeve sociale nga komunat;
- Të rekrutohen ekspertë të fushave të ndryshme për të mbështetur gjykatësit dhe prokurorët në njësi të ndryshme, veçanërisht në atë të krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Të ndahet buxhet për secilën strategji, konkretisht Strategjinë Kombëtare Kundër-Korrupsion për të tëra vitet në të cilat kjo strategji është në fuqi;
- Të ndahen mjete financiare për të rekrutuar staf për trajtimin e migracionit dhe azilit në MPB;
- Të rritet shuma e buxhetit për hulumtime dhe për programet ekzistuese për trajnimin e mësimit dhe zhvillimin e plan programeve për shkak të ndikimit të tyre në cilësinë në arsim dhe përshtatjen me nevojat e tregut, respektivisht;
- Të ndahen më shumë mjete për sektorin e shëndetësisë, qoftë atë primare apo sekondare, specifikisht për diagnostifikimin dhe trajtimin e pacientëve.

# Anekset

## Aneks 1

	<b>21 ministri</b>	<b>13 ministri</b>	<b>Paga vjetore</b>	<b>Dreka në vit</b>	<b>Telefon mobil në vit</b>	<b>Fiks telefon</b>	<b>Total</b>	<b>Total viti 21</b>	<b>Total viti 13</b>
<b>Kryeministri</b>	1	1	€35,400				€35,400	€35,400	35,400
<b>Zëvendës-kryeministra</b>	5	2	€30,000	€10,000	€ 3,000	€2,400	€45,400	€227,000	€90,800
<b>Ministria</b>	21	13	€24,000	€6,000	€3,000	€1,800	€34,800	€730,800	€452,400
<b>Zëvendës-ministra</b>	71	13	€13,800	€2,400	€1,800	€1,200	€19,200	€1,363,200	€249,600
<b>Këshilltari i lartë i Kryeministrit</b>	1		€22,200	€1,200	€840	€600	€24,840	€24,840	€-
<b>Shefi i stafit i Kryeministrit</b>	1	1	€16,800	€1,200	€840	€600	€19,440	€19,440	€19,440
<b>Shefi i kabinetit të Kryeministrit</b>	1	1	€20,040	€1,200	€1,800	€1,200	€24,240	€24,240	€24,240
<b>Këshilltar i Kryeministrit</b>	18	4	€16,080	€1,200	€840	€-	€18,120	€326,160	€72,480
<b>Këshilltar i lartë i Zv.Kryeministrit</b>	3		€14,400	€1,200	€840	€-	€16,440	€49,320	€-
<b>Këshilltarë të Zv. Kryeministrave</b>	15	8	€13,200	€1,200	€840	€-	€15,240	€228,600	€121,920
<b>Këshilltarë të lartë të ministrave</b>	21		€12,600	€1,200	€840	€-	€14,640	€307,440	€-
<b>Këshilltarë të ministrave</b>	126	52	€9,600	€1,200	€840	€600	€12,240	€1,542,240	€636,480

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

